



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT DHE INVESTIMEVE PUBLIKE

Nr. _____ prot.

Pukë më, _____, 11, 2024

PROJEKT-VENDIM

Nr. _____, Datë ____/ 11 /2024.

**PËR
PROCEDURAT E PRIORITETEVE PËR INVESTIME E SHËRBIME PËR VITIN 2025**

Në zbatim të:

- Nenit 3, nenit 4, nenit 23, nenit 27, nenit 54, nenit 55, të ligji nr.139/2015 "Për Vetëqeverisje Vendore" (i ndryshuar);
- Ligjit nr.68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore";
- Ligjit nr.10296/2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", (i ndryshuar);
- Ligji nr.9936/2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", (i ndryshuar);
- Ligjit nr.88/2019 "Për buxhetin e vitit 2022";
- Udhëzim nr. 30/2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik";
- Udhëzimin nr.9/2018 "Për Procedurat Standarte te Zbatimit te Buxhetit"
- Parashikimeve për investime në PPV-në për Bashkinë Pukë,

me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak pasi mori në shqyrtim kërkesën:

VENDOSI:

Të miratojë listën e prioriteteve për investime e shërbime në Bashkinë Pukë për vitin 2025 si me poshtë vijon:

Bashkia Pukë

1. Sisitemimi dhe rivitalizimi i lagjeve të qytetit, (Sipër Muzeumit, Pas Bankës, Hyrje e qytetit nga Gjykata deri te Gjinnazi) rrugët, sipërfaqet e gjelbërta, fasadat, oxhaqet, kthimi i tarracave në çati për pallatet,

2. Rikonstruksion i plotë i unazës së vogël të qytetit rruga “Halil Terbuni”,
3. Asfaltimi i rrugës dhe përmirësimi i trotuareve, rruga kryesore e Qytetit Pukë,
4. Lidhja me shëtitore të dy liqeneve në Pukë dhe rikualifikimi i sipërfaqeve dhe kthimi në parqe kreative rreth liqenit Kukaj.
5. Ndërtimi ose përmirësimi i sistemit të ujrave të zeza dhe ndërtimi i një impiantit të trajtimit të ujrave të përdorura,
6. Rikonstruksion total i godinës së bashkisë (hidroizolim tarrace, përmirësimi i hapsirave të brendshme, instalim Sistem ngrohje)
7. Asfaltimi i rrugës së lagjes Zezaj dhe kanali anësor i ujrave sipërfaqësore të saj,
8. Ndërtim i kanalit anësor Zyra Arsimore - ura pranë OSHEE,
9. Sistemimi dhe Asfaltimi i rrugës në lagjen e Re nga kabina deri te varrezat
10. Emergjente “Ndërhyrja në vend-grumbullimin e mbetjeve urbane”
11. Rikonstruksion total i shkollës 9-vjeçare “Migjeni” Pukë,
12. Ndërhyrje me rikonstruksion të pallatit të Tërmetit zëvendësim i fasadës Jugore dhe shtresat e hidroizolimit të soletës pasi janë të dëmtuara dhe kanë bërë të pabanushme 5 apartamentet që preken nga kjo fasadë.
13. Rikonstruksion i dëmeve të konstatuara në pallatin e ish NSHN-së i investuar 2 vite më parë
14. Rikonstruksion i shkollës fillore kthimi dhe përshtatja për banesa për njerëzit në nevojë
15. Evidentim i hapsirave të papërdorshme dhe investimi i tyre për kthimin e tyre në efikasitet
16. Vendosje e Info Point Qendër e informimit të turistëve si një qendër për libra, harta, guida turistike për të eksploruar rrethinat(mjedisin);
17. Përshtatje e një hapsire për linjen Alo 24 dhe strehimin për mbrojtjen e rasteve të dhunës në familje
18. Shpërndarje e EIFI falas në qytet për turistët e vizitorët (kontratë me rrjetet e telefonisë)
19. Ndriçimi dhe sistemimi i rrugës së Tuneleve (nga Diga e liqenit deri te rruga Lagje e Re) - qyteti Pukë (kthimi i tuneleve në atraksion turistik)
20. Ndërtimi dhe përmirësimi i rrugëve të lagjes Laçaj, Kurtaliaj, Mehaj, Lajthizë)
21. Ndërtimi i KUZ-ve në lagjet periferike, ish – SMT, Elektriку – Zona e ish kampi Kosovarëve
22. Përmirësim dhe vendosje e shtresave dhe veprave të artit në rrugen Pukë – Kabash
23. Qendër kreative blloku me pisha ish antena e RTSH^{së} përgjatë rrugës së Kabashit, Park pushimi tek blloku i gështenjave pranë banesave sociale,
24. Qendër kreative, Mrizi i Memajve
25. Kënd lojrash për fëmijë (ish këndi i lojrave)
26. Ndriçim i rrugës së lagjes Kukaj dhe segmenti N/Stacioni Elektrik – banesa e Kujtim Selmani,
27. Vijëzim i rrugëve kryesore në qytet,
28. Rikonstruksion i fasadave në të gjitha sipërfaqet ku kanë pësuar dëmtime, oxhaqet, çatitë (të ndërtuara me projektin rikualifikimi urban)

29. Rikonstruksion dhe shërbime në pllakat e pedonale e kanalet e ujrave sipërfaqësorë që janë kthyer në shqetësim (të ndërtuara me projektin rikualifikimi urban)
30. Sinjalistike turistike (Guri i shenjtë i Shpalit, Kisha e Kabashit, Shpella e Orëve Shkozë, etj. të shtohen sipas propozimeve të ekspertëve të fushave të ndryshme), info Point, markimi dhe Digjitalizimi i shtigjeve malore dhe vendeve atraktive turistike,
31. Përmirësimi i kushteve të stacionit të autobusave, ndërtim i mbuleses, këndi i orareve dhe destinacioneve, ndertim i banjove publike.
32. Rrugë dhe mure mbajtëse varrezat ekzistuese të qytetit, aplikimi për shtesë të re të sipërfaqes së Varrezave
33. Ballkon panoramik afër stacionit Zip – Line
34. Rikonstruksion i shkollës Muze “Migjeni”
35. Përforcimi i kollonave të urës këmbësore te diga e liqenit për rrugën Laçaj

Njësia Administrative Luf-Qerret

1. Rikonstruksion i pallatit 3-katësh ne Luf-Qendër,
2. Shtrim me çakull të rrugeve Qerret , Rruga Filipaj , Rruga Korthpule , Rruga Vrrith, Rruga Seferaj,
3. Ndërtimi i fushës sportive në hapësirën e shkollës Luf,
4. Ndërtim i rrjetit të ujësjellësit të fshatit Qerret,
5. Zgjatimi i rrjetit të ujit vaditës fshati Qerret,
6. Ndërtimi i urës (me tombino) lagja Tafilakëve, fshati Qerret,
7. Vazhdimi i shtrimit të rrugës në të gjitha lagjet e fshatit Qerret.
8. Furnizimi me ujë i shkollës në Qerret dhe i banesave në lagjen nr.2.
9. Restaurim i rrjetit të ujit të pijshëm fshati Gomsiqe,
10. Restaurim i pjesshëm i kanalit vaditës fshati Gomsiqe,
11. Rikonstruksion i ujsjellësit në fshatin Plet – Uragji,
12. Rruga e fshatit Kaftall
13. Ura Kaftall

Njësia Administrative Qelëz

1. Rikonstruksion pjesor i objektit të Njesisë Administrative Qelëz
2. Riparime/ndërrhyrje në kanal in vaditës fshati Dedaj,
3. Ndërtimi i kanalit vaditës në lagjen Gugaj – Qelëz
4. Restaurim i pjesshëm i rezervuarit të vogël Midhë,
5. Ndërtim ure në fshatin katund, lagja Balaj-Kovaçaj,
6. Riparime në kanalet vaditëse të fshatrave Bushat dhe Midhë,
7. Riparim i urës këmbësore në lagjen Breg (poshtë urës së madhe),
8. Sistemimi i rrugës Qelëz – Ukth

9. Ndërtim i kanalit vaditës për lagjen Gugaj

Njësia Administrative Rrape

1. Ndërtim ura auto fshati Bicaj (ish rep. ushtarak),
2. Ndërtim ujësjellësi me shpim, shkolla Breg,
3. Restaurim i oborrit të shkollës Rrape,
4. Ndërtim me vepra arti e shtresa dhe vendosje e shtyllave të ndriçimit të rrugës Pukë – Kabash
5. Sistemimi i dy varrezave të fshatit Kabash
6. Investime për Kishen Kabash si atraksion turistik
7. Investim i rrugës së Kabashit – njësia Administrative Rrape
8. Hapje rruge Memaj - lagje Llukë
9. Fadromë e vogel 90 KW.
10. Rrethimi i varrezave fshatit Breg.
11. Riparimi i urës Breg me shtresë betoni.
12. Shtrimi me çakull i rrugës Breg.
13. Vendosja e 5 tombinave në rrugen Breg.
14. Zgjerimi i rrugës Kavlinë dhe shtrimi me çakull dhe vendosja e 10 tombinove për kalimin e ujërave.
15. Riparimi i ujësjellësit lagje Kavlin.
16. Lyerja me bojë e hekurave anësore në uren Kavlinë, Breg.
17. Rregullimi i mullirit të vjetër Kavlinë.
18. Mur mbajtës i gjithë segmenti i rrugës Bicaj me gurë dhe rrjetë metalike edhe 5 tombina për kalimin e ujërave.
19. Riparimi i ujësjellësit Bicaj.
20. Riparim i kanalit vadites Kavlinë, Breg.
21. Rruga Krovë, fshati Blinisht dhe rruga Bojagjive riparim dhe sistemim me çakull dhe një urë me turbina.
22. Rruga Prozhem një urë me tombina dhe shtrim me çakull.
23. Hapja e rrugës të fshatit Lumzi (rrugë e re një nga prioritetet më të nevojshme për momentin).
24. Ujësjellësi i ri Rrape.
25. Riparim i tualeteve të Shkollës Rrape.
26. Riparim i tualeteve të Njesisë Administrative Rrape.
27. Ujësjellësi Kabash.
28. Kanali vaditës Kabash.
29. Riparimi i Shkollës Kabash.
30. Riparimi i rrugës Meçe.
31. Urë kalimi me tombina fshatit Meçe.

32. Rrethimi i varrezave Hadroj, Rrape, Rrype, Bicaj, Kabash, Memaj, Prozhem.
33. Fshati Blinisht mbjellje 8000 fidanë Akacie përafërsisht me vlerë 1.000.000 lekë (të reja).
34. Fshati Rrape mbjellje me fidanë pishë 20.000 copë 2.500.000 lekë (të reja).
35. Fshati Buhot prita malore me funksion mbrojtje.
36. Pastrim i sipërfaqeve pyjore në Njësinë Administrative Rrape.
37. Një ndërtim pistë për hipizëm.
38. Ndërtim i një piste për motorra në mal për turizem.
39. Kompletimi i gjitha rrugëve të Njësisë Administrative Rrape me tabela dhe me emra për të gjitha rrugët e fshatrave dhe lagjeve.

Njësia Administrative Gjegjan

Fshati Gjegjan:

1. Zgjerim i vendit për varreza në fshatin Gjegjan si dhe rrethimi i tyre
2. Rikonstruksion i rrugës së Gjegjanit Haxhiaj+Pacaj zgjerim dhe hapje xhepush për ndërrim makinash.
3. Riparim dhe ndërtim i urës pasarelë të fshatit Gjegjan (Ura Lajthiz) me Lllamarinë
4. Ndërtim i çezmës publike në qendër Gjegjan
5. Riparimi i rrjetit të ndriçimit në Gjegjan
6. Hapje rruge e re lagje Zaj
7. Hapje rruge e re Haxhiaj –Varrezet Gjegjan
8. Riparimi i kanalit vadites ne Lagjen Lajthiz
9. Rikonstruksion në kanalini e ujërave të zeza në qendër Gjegjan

Fshati Dom

1. Uji vadites, fshati Dom nga Sefta
2. Riparim i urave Dom, lagje Përshpalaj+Ura Caraj+Vathaj
3. Shtrimi me shtresë betoni në rrugën auto me gjatësi 100 ml në lagjen Caraj
4. Riparimi dhe hidroizolimi i pusit të uijt për vaditje lagje Sulaj
5. Ndërtimi i urës së makinës mbi lumin Fan për lagjen Vathaj Përshpalaj
6. Ndërtimi i ujësjellësit për lagjen Vathaj Përshpalaj

Fshati Rras

1. Sifoni i Rrasit preventiv nga urbaneastika
2. Ndërtimi i turbinave në rrugën e fshatit Rras.
3. Zgjerimi dhe rrethimi i Varrezave
4. Ndërtim ujësjellës për Fshatin Rras

Fshati Kuzhnen

1. Ndërtimi i urës së makinës tek shkolla e Rrasit mbi lumin Fan

2. Ndërtim ure në rrugen Sherraj HEC Shutine
3. Riparim në rrugen Sherraj si dhe ndërtimi i 4 tombinove në pproskat e kësaj rruge
4. Riparime në ujësjellësin e fshatit Kuzhnen
5. Ndërtimi i tombinës në rrugen Fush-Ranzë si dhe zgjatja e kësaj rruge rreth 50 ml gjatësi
6. Shtrimi i 50 ml rruge makine me beton tek Sumajt
7. Riparimi i rrethimit tek varrezat e fshatit Kuzhnen

Fshati Gojan i Vogel

1. Përfundimin e projektit të ujit vaditës për të gjitha lagjet e fshatit Gojan i Vogel
2. Ndërtim muri mbajtës në rrugen Gojan i Vogel Lagje Kodërkmonë
3. Ndërtim ure ose me tombinë në lagjen Bardhaxhi Fshati Gojan i Vogel
4. Ndërtim dhe zgjatim rruge për lagjen Bacaj fshati Gojan i Vogel gjatësi afërsisht 150 m
5. Ndriçim i qendrës Gojan i Vogel
6. Hapje rrugë auto për lagjen Ceraj
7. Hapje rrugë auto për lagjen Bardhaxhi

Fshati Gojan i Madh

1. Vendosje tubash në prerjen e rrugëve të fshatit tuba çeliku Ø 250 mm
2. Ndërtim dhe zgjatim rruge lagje Groftaj Fshati Gojan i Madh me gjatësi rreth 1 km
3. Rindërtim ure pasarele me dërrasë, lagje Mekth fshati Gojan i Madh
4. Ndriçimi i qendrës Gojan i Madh.
5. Riparimi i vijës vaditëse për lagjen Brigje
6. Sigurimi i ngrohjes së shkollës
7. Shtrimi me beton i vijës vaditëse në lagjen Brigje
8. Ndërtimi i terrenit sportiv tek shkolla Gojan i Madh

Fshati Shkozë

1. Riparim i rrugës krye-katundi, (zbutje e 1 maloreje dhe riparim i 2 kthesave me fadromë), si dhe shtrim i saj me material çakëll së paku 300 ml.
2. Riparim të kanaleve vaditëse për lagjen Sulaj dhe pjesës sipër fshatit
3. Riparim i urës pasarelë të lagjes Tejfane, shtrim i pjesshëm i saj me dërrasë
4. Krasitje të Çarrave në varrezat e fshatit.
5. Shtim të koshave të mbeturinave përgjatë rrugës automobilistike.
6. Ndriçim i qendrës.
7. Riparimi i mullirit të fshatit
8. Hapje rruge makine në lagjen Breg –Fan

Fshati Kimëz

1. Riparimi i mullirit të fshatit Kimez
2. Ujësjellës për fshatin

3. Riparimi i rrugës dhe hapje kanali për rrugen Kalivare- Kimëz

Fshati Mesul

1. Zgjerim të rrugës ekzistuese
2. Ujësjiellës për Fshatin
3. Riparimi i kanaleve vaditëse

Fshati Kalivare

1. Ujësjiellës për Fshatin
2. Ndërtim urë për makina për lagjen Zalli i poshtëm
3. Riparimi dhe zgjerimi i rrugës së makinës deri tek varrezat dhe ndërtimi i një vendi për shesh parkim tek varrezat

Ngarkohet Administrata e Bashkisë Pukë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në bazë të ligjit nr.139/2015 “Per Vetëqeverisjen Vendore”.

Hartuesi

Drejtorja e Pl. të territorit
Ing. Lindita Hyseni

Juristi
Aida Sinani

KRYETARI
RROK DODAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT DHE INVESTIMEVE PUBLIKE

RELACION

Nr. _____ prot.

Pukë më 15. 11. 2024

PËR
PROÇEDURAT E PRIORITETEVE PËR INVESTIME E SHËRBIME PËR VITIN 2025

Në kuadër të hartimit të objektivave për Zhvillimin Urban dhe atë Rural Bashkia Pukë ka hartuar për vitin 2025 listën e prioriteteve për investime, ku janë të përfshira shërbime, sistemime dhe ndërtime të objekteve të ndryshme.

Duke u mbështetur në gjendjen fizike të infrastrukturës ekzistuese, në plotësimin e nevojave në rritje për investime në infrastrukturë në territorin e Bashkisë Pukë, si dhe për të krijuar një mjedis sa më funksional, estetik dhe bashkëkohor brenda këtij territori, janë parashikuar rikonstruksionet e rrugëve, urave, rehabilitimi i hapësirave publike, shërbime apo ndërtime në kanalet vaditëse, pastrimi i territorit nga objektet e degraduara dhe të papërdorshme, përmirësimi i disa objekteve për kthimin e tyre në hapsira të përdorshme kryesisht për strehimin e njerëzve në nevojë, përmirësimi i infrastrukturës në shkolla, shërbime dhe rikonstruksione në godinat në varësi të Bashkisë, etj. të cilat do të kenë impakt të drejtëpërdrejtë te nevojat e qytetarëve.

Lista për investimet përmban objekte të ndryshme, në të cilat është e nevojshme ndërhyrja për të ofruar një shërbim më të mirë ndaj komunitetit, duke i shënuar për prioritete të gjitha problematikat e evidentuara ndër vite por edhe të dala gjatë dëgjësave publike për buxhetin.

Listës mund ti shtohen prioritete të tjera që mund të mos jenë shënuar në këtë listë gjatë shqyrtimit në mbledhjen e këshillit.

Për sa më sipër kërkohet nga ana juaj miratimin e projekt-vendimit për procedurat e prioriteteve për investime e shërbime për vitin 2025.

Faleminderit !

Drejtorja e Pl. të territorit dhe Inv. Publike

Ing. Lindita Hyseni

KRYETARI I BASHKISË

RROK DODAJ